

VENDIM
Nr.107, datë 29.12.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC BISHNICA 1, 2” SHPK

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a” të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.12.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC Bishnica 1,2” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, për HEC Bishnica 2, dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- Dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Miratimin e OST sh.a. ose OSSH sh.a. për lidhjen e centraleve me sistemin elektroenergjetik është shoqëruar nga miratimi për pikën e lidhjes nga Drejtoria Rajonale e OST sh.a. Elbasan dhe është në pritje të përgjigjes nga Drejtoria Qendrore për ta paraqitur më pas në ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “HEC Bishnica 1,2” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike për HEC Bishnica 2.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta